



BULETIN MUJOR

MAJ 2026



PËRMBAJTJA

Western Balkans Cyber Camp 2026, një hap më tej për zhvillimin e talenteve kibernetike në rajon

- Western Balkans Cyber Camp 2026, një hap më tej për zhvillimin e talenteve kibernetike në rajon
- Nis cikli i trajnimeve për institucionet e pavarura mbi masat e sigurisë kibernetike
- Miratohet ligji për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital
- Shqipëria i bashkohet NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE)
- Përmbillet cikli i aktiviteteve ndërgjegjësuese për sigurinë online të fëmijëve
- Nis Programi Kombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike për SME-të



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi në Durrës edicionin e radhës të Western Balkans Cyber Camp 2026, një iniciativë rajonale e dedikuar zhvillimit të talenteve të reja në fushën e sigurisë kibernetike. Kampi mbledhi të rinj, studentë dhe profesionistë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët patën mundësinë të marrin pjesë në sesione teknike, diskutime interaktive dhe aktivitete praktike të fokusuara në sfidat dhe zhvillimet më të fundit të sigurisë kibernetike.

Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit zhvilluan aftësitë e tyre përmes ushtrimeve praktike dhe garës Capture The Flag (CTF), duke forcuar njohuritë në identifikimin dhe menaxhimin e kërcënimeve kibernetike. Përmes këtij kampi, AKSK vijon të kontribuojë në ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm profesionistësh dhe talentesh të reja, duke nxitur bashkëpunimin rajonal dhe përgatitjen e brezit të ardhshëm të ekspertëve të sigurisë kibernetike.

Nis cikli i trajnimeve për institucionet e pavarura mbi masat e sigurisë kibernetike



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka nisur një cikël trajnimesh të dedikuara për institucionet e pavarura, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e nivelit të përgatitjes për zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e sigurisë kibernetike. Trajnimet bëjnë pjesë në angazhimin e vazhdueshëm të AKSK për të mbështetur institucionet në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i ri për sigurinë kibernetike.

Gjatë sesioneve të para, pjesëmarrësit u njohën me masat e sigurisë kibernetike, proceset e menaxhimit të riskut, detyrimet e raportimit të incidenteve, si dhe mekanizmat e vlerësimit dhe monitorimit të nivelit të sigurisë. Ky cikël trajnimesh synon të krijojë një qasje të unifikuar dhe të qëndrueshme për forcimin e sigurisë kibernetike në institucionet e pavarura dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë së ekosistemit digjital në vend.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039

MAJ 2026



MIRATOHET LIGJI

“Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”

Miratohet ligji për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”, i përafuar plotësisht me rregulloret e Bashkimit Evropian eIDAS1 dhe eIDAS2. Ligji krijon bazën për zbatimin e politikave më të avancuara evropiane në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, duke forcuar sigurinë, besueshmërinë dhe ndërveprueshmërinë e shërbimeve digjitale në Shqipëri.

Ndër risitë kryesore të ligjit është krijimi i Portofolit të Identitetit Digjital, i cili do t'u mundësojë qytetarëve të ruajnë, menaxhojnë dhe ndajnë në mënyrë të sigurt të dhënat e identifikimit dhe dokumentet elektronike, si edhe të nënshkruajnë dokumente në format elektronik. Ligji zgjeron gjithashtu gamën e shërbimeve të besuara dhe forcon mekanizmat e mbikëqyrjes për skemat e identifikimit elektronik dhe ofruesit e këtyre shërbimeve, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe shërbimeve digjitale në vend.

Shqipëria i bashkohet NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE)

Shqipëria u bë zyrtarisht pjesë e NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE), qendra e ekselencës së NATO-s për mbrojtjen kibernetike me seli në Tallinn, Estoni. Anëtarësimi u formalizua gjatë ceremonisë së ngritjes së flamurit në selinë e qendrës, ku Shqipëria iu bashkua Finlandës dhe Suedisë, duke u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të ekspertizës kibernetike që bashkon 39 vende anëtare dhe partnere.

Anëtarësimi në CCDCOE i jep Shqipërisë mundësinë të kontribuojë dhe të përfitojë nga kërkimi shkencor, trajnimet, ushtrimet ndërkombëtare dhe shkëmbimi i ekspertizës në fushën e mbrojtjes kibernetike. Përmes këtij bashkëpunimi, vendi forcon më tej rolin e tij në strukturat e sigurisë euroatlantike dhe zgjeron mundësitë për zhvillimin e kapaciteteve kombëtare në përballjen me kërcënimet kibernetike.



Përmbillet cikli i aktiviteteve ndërgjegjësuere për sigurinë online të fëmijëve

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike përmbylli ciklin e aktiviteteve ndërgjegjësuere për sigurinë online të fëmijëve për vitin shkollor 2025–2026, duke zhvilluar aktivitetin e fundit me nxënësit e shkollës “Vatra e Dijes” në Tiranë. Përmes bashkëbisedimeve dhe diskutimeve interaktive, fëmijët u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, përdorimit të sigurt të internetit dhe mënyrave për të identifikuar dhe shmangur rreziqet online.

Gjatë vitit shkollor 2025–2026, AKSK zhvilloi 39 aktivitete ndërgjegjësuere në disa zona të Shqipërisë, duke përfshirë 36 sesione ndërgjegjësimi, 1 webinar, 1 trajnim për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe 1 tryezë të rumbullakët me institucionet përgjegjëse. Në total, 1,675 fëmijë dhe pjesëmarrës u bënë pjesë e këtyre aktiviteteve, të realizuara në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me synimin për të forcuar kulturën e sigurisë digjitale dhe për të promovuar një mjedis online më të sigurt për brezat e rinj.

Nis Programi Kombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike për SME-të

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një takim me organizata dhe institucione mbështetëse të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), me fokus prezantimin e Programit Kombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike për SME-të. Takimi shërbeu si një platformë për diskutimin e sfidave që lidhen me sigurinë kibernetike të bizneseve, në një kohë kur dixhitalizimi i proceseve dhe përdorimi i shërbimeve online po rrit ekspozimin ndaj kërcënimeve kibernetike.

Programi do të zbatohet në disa faza dhe përfshin aktivitete ndërgjegjësuere, vlerësimin e maturisë kibernetike të bizneseve, trajnime praktike dhe mbështetje teknike për implementimin e zgjidhjeve mbrojtëse “Open Source”. Gjithashtu, rezultatet dhe eksperiencat e mbledhura gjatë këtij procesi do të shërbejnë për hartimin e “Manualit Shqiptar të Sigurisë Kibernetike për SME-të”, një dokument praktik i dedikuar forcimit të sigurisë dhe qëndrueshmërisë digjitale të bizneseve shqiptare.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039